



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Prishtinë 06 KORRIK 2020

Me qëllim të ndërmarrjes së masave sipas pikës 6 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/10 të datës 05.07.2020 lidhur me menaxhimin e situatës epidemiologjike në vend, Ministri i Drejtësisë nxjerrë këtë:

Q A R K O R E

Pika 6 e Vendimit nr. 01/10, dt: 05.07.2020, përcakton se: *“Institucionet publike dhe private të Kosovës obligohen të reduktojnë numrin e të punësuarve vetëm në nivel të stafit të domosdoshëm (institucionet përkatëse do të sqarojnë me qarkore të veçanta se çfarë paraqet staf të domosdoshëm për to).”*

1. Në rrjedhë të kësaj, obligohen Agjencitë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, departamentet dhe divizionet përkatëse, që të reduktojnë stafin e të punësuarve në një numër minimal në zyrë me qëllim të ruajtës së distancës fizike.
2. Me qëllim të kryerjes së detyrave të domosdoshme zyrtare në Ministrinë e Drejtësisë, obligohen kryeshefat e Agjencive Ekzekutive, drejtorët e departamenteve dhe udhëheqësit e divizioneve, që të planifikojnë punën në dikasteret e tyre përkatëse përmes sistemit rotativ të punës mes zyrtarëve në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.
3. Nënata vetushqyese dhe me fëmijë më të vogël se 1 vjeç si dhe zyrtarët/et mbi moshën 60 vjeçare si dhe ata që kanë sëmundje kronike lirohen nga prezenca fizike në zyrë dhe obligohen që të jenë në dispozicion për kryerjen e detyrave zyrtare nga shtëpia.
4. Personat zyrtarë të cilët kanë simptoma të infeksionit Covid-19 apo eventualisht janë raste të kontaktit të personave që kanë rezultuar pozitiv me Covid-19 obligohen të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.
5. Kjo qarkore hyn në fuqi menjëherë.



Qarkorja i'u dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Kryeshefave të Agjencive;*
- *Drejtorëve të departamenteve;*
- *Udhëheqësve të divizioneve.*